



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 65 datë 30.12.2015

“Një ndryshim në vendimin e këshillit bashkiak nr.25, datë 16.05.2006 mbi “Përcaktimin e linjave të transportit qytetës të udhëtarëve, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe ripërcaktimi i stacioneve të qëndrimit të autobusëve të shërbimit në këto linja (i ndryshuar) për linjën nr.13 “Qyteti i Studentit”, për ndryshimin në emërtimin dhe itinerarin e Linjës nr.13, në rrjetin e linjave qytetase të transportit të udhëtarëve.

Në mbështetje nenit 7, pika 2, nenit 10/3/I, shkronja “d”, nenit 32, shkronja “k” dhe nenit 33, pika 2 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (i ndryshuar); ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 14 të ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 për “Transportet Rrugore” (i ndryshuar); udhëzimit nr.15, datë 24.07.2007 për “Kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak nr.25, datë 16.05.2006 mbi “Përcaktimin e linjave të transportit qytetës të udhëtarëve, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe ripërcaktimi i stacioneve të qëndrimit të autobusëve të shërbimit në këto linja” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e emërimit të **Linja Nr. 13 “Qyteti i Studentit”**, të përcaktuar në pikën 1 dhe 2, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.25, datë 16.05.2006 mbi “Përcaktimin e linjave të transportit qytetës të udhëtarëve, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe ripërcaktimi i stacioneve të qëndrimit të autobusëve të shërbimit në këto linja” (i ndryshuar), në **“Linja nr. 13 “Qendër – Qyteti Studenti – Qendër” riemërtohet “Qyteti Studenti – Qendër-Shinat e Trenit – Qyteti Studenti”**”.
2. Ndryshimin e pikës 2, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.25, datë 16.05.2006 mbi “Përcaktimin e linjave të transportit qytetës të udhëtarëve, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe ripërcaktimi i stacioneve të qëndrimit të autobusëve të shërbimit në këto linja” (i ndryshuar), që parashikon linjën Nr. 13 të sipërpërmendur, nga një linjë me 11 stacione në segmentin “a” në linjë me 16 stacione, dhe nga 10 stacione në segmentin “b” në 15 stacione.
 - Linja Nr. 13 “Qyteti Studenti – Qendër- Shinat e Trenit – Qyteti Studenti” segmenti “a” përshkron këtë itinerar:
Fillon tek “Rezervuarët e Ujit”, vijon në rrugën “Pjetër Budi”, futet në “Qyteti i Studentit”, dhe tek Drejtoria e “Qytetit Studenti” kthehet në rrugën “Arben Broci”, del tek

Fakulteti Ekonomik, kthehet djathtas duke dalë në rrugën e “Elbasanit” dhe vijon përgjatë saj, kalon mbi urën e lumit “Lana”, vijon në rrugën “Xhorxh Ë. Bush”, kthehet tek “Biblioteka Kombëtare”, futet në sheshin “Skënderbej” dhe vazhdon përgjatë Bulevardit “Zogu I”, kthehet majtas tek ish – Stacioni i Trenit në rrugën “Asim Vokshi”, kthehet djathtas në rrugën “Jordan Misja” deri tek stacioni Shinat e Trenit apo (fundi rrugës “Jordan Misja”).

- Linja Nr. 13 “Qyteti Studenti – Qendër- Shinat e Trenit – Qyteti Studenti” segmenti “a” përshkron këtë itinerar:

Fillon tek “Rezervuarët e Ujit”, vijon në rrugën “Fuat Toptani”, vazdon në rrugën “Fuat Toptani” pranë “Universitetit Ndërkombëtar”, del në rrugën e “Elbasanit”, vijon përgjatë saj, kalon mbi urën e lumit “Lana”, vijon në rrugën “Xhorxh Ë. Bush”, kthehet tek “Biblioteka Kombëtare”, futet në sheshin “Skënderbej” dhe vazhdon përgjatë Bulevardit “Zogu I”, kthehet majtas tek ish – Stacioni i Trenit në rrugën “Asim Vokshi”, kthehet djathtas në rrugën “Jordan Misja” deri tek stacioni Shinat e Trenit apo (fundi rrugës “Jordan Misja”).

Në kthim, të dyja segmentet “a” dhe “b” ndjekin të njëjtin itinerar, kur vijnë tek Sheshi “Skënderbej” stacionohen në rrugën “28 Nëntori

1. Kryetari Bashkise përcakton parametrat (oraret, frekuencat, numrin e mjeteve, etj) që duhet të plotësojë shërbimi i transportit qytetës në këtë linjë.
2. Stacionet e ndalimit:
 - 1.1 Segmenti “a” ka këto stacione ndalimi të autobusit:

Stacioni Nr. 1 - “Rezervuarët e Ujit”.

Stacioni Nr. 2 - Kryqëzimi i Rrugës “Fuat Toptani” me Rrugën “Pjetër Budi”.

Stacioni Nr. 3 - Karburanti “Martini Petrol”.

Stacioni Nr. 4 - Kryqëzimi i Rrugës “Pjetër Budi” me Rrugën “Kristaq Capo”.

Stacioni Nr. 5 - Kryqëzimi i Rrugës “Pjetër Budi” me Rrugën me Rrugën “Dajti”.

Stacioni Nr. 6 - Godina 26, në afërsi të Rrugës “Pjetër Budi”.

Stacioni Nr. 7 - Godina 15 (familjarët).

Stacioni Nr. 8 - Fakulteti Ekonomik.

Stacioni Nr. 9 - Liceu Artistik “Jordan Misja”.

Stacioni Nr. 10 - Posta në Rrugën e “Elbasanit”.

Stacioni Nr. 11 - Në Qendër, pranë Bibliotekës Kombëtare.

Stacioni Nr. 12 - Tek Hotel Tirana Internacional (15 Katëshi).

Stacioni Nr. 13 - Përballë Fakultetit të Shkencave të Natyrës.

Stacioni Nr. 14 - Tek Rruga “Jordan Misja”, afër Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale “Jordan Misja”³¹³.

Stacioni Nr. 15 – Pranë kryqëzimit të Rrugës “Jordan Misja” me Rrugën “Demir Progri”.

Stacioni Nr. 16 - Tek Shinat e Trenit (fundi Rrugës “Jordan Misja”).

Në Kthim Stacioni Nr. 11 Në rrugën “28 Nëntori”.

- 1.2 Segmenti “b” ka këto stacione ndalimi të autobusit:

Stacioni Nr. 1 - “Rezervuarët e Ujit”.

Stacioni Nr. 2 - Kryqëzimi i parë i Rrugës “Fuat Toptani” me Rrugën “Irfan Tërshana”.
Stacioni Nr. 3 - Kryqëzimi i Rrugës “Fuat Toptani” me Rrugën “Dajti”.
Stacioni Nr. 4 - Kryqëzimi i dytë i Rrugës “Fuat Toptani” me Rrugën “Irfan Tërshana”.
Stacioni Nr. 5 - Universiteti Ndërkombëtar.
Stacioni Nr. 6 - Vilat Gjermane.
Stacioni Nr. 7 - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.
Stacioni Nr. 8 - Liceu.
Stacioni Nr. 9 - Posta në Rrugën e “Elbasanit”.
Stacioni Nr.10 - Në Qendër, pranë Bibliotekës Kombëtare.
Stacioni Nr. 11 - Tek Hotel Tirana Internacional (15 Katëshi).
Stacioni Nr. 12 - Përballë Fakultetit të Shkencave të Natyrës.
Stacioni Nr. 13 - Tek Rruga “Jordan Misja”, afër Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale “Jordan Misja”³¹³.
Stacioni Nr. 14 - Pranë kryqëzimit të Rrugës “Jordan Misja” me Rrugën “Demir Progri”.
Stacioni Nr. 15 - Tek Shinat e Trenit (fundi Rrugës “Jordan Misja”).

Në Kthim Stacioni Nr. 11 Në rrugën “28 Nëntori”.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Transportit dhe Trafikut Rrugor, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit, si dhe Operatorët e transportit qytetës në Bashkinë e Tiranës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

ALDRIN DALIPI